



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2024

**VENDIM**

**Nr. 26, datë 24.01.2024**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR  
PERIUDHËN 2020 - 2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për periudhën 2020-2022”, i hartuar nga relatores znj. Yllka Rupa,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtares {...}, për periudhën 2020-2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarës bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson {...}t ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarës pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

### 1.A Njohuritë ligjore.

*1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.*

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:*

*Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes apo natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale gjatë fazës së ekzekutimit) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimin të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.*

Në pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në rastin e vendimeve penale themeli, në një nënndarje të titulluar “Procedura”, gjyqtarja jep kronologjinë e veprimeve procedurale të bëra në seance paraprake si kërkesën e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar;<sup>1</sup> aspektet procedurale të seancës paraprake etj, më pas nënndarja. Ndërsa në vendime civile në pjesën hyrëse të vendimit përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore (nenet 41, 43, 54 dhe nenet

---

<sup>1</sup> Të gjitha vendimet burim vlerësimi të kategorisë çështje penale themeli

36/1 dhe 59 të K.Pr.C) përbërjen e trupit gjykues i përberë nga një gjyqtar apo tre (neni 35 i K.Pr.C), evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me pakësim apo shtim objekti.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (*penale, civile ose familjare*) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: procedura e gjyqimit (*gjykim i shkurtuar apo i zakonshëm në çështjet penale*), zhvillimi i gjyqimit në prezencë ose mungesë të palëve, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtarja parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje përgjithësisht të titulluar “Rrethanat e çështjes”, duke i parashtruar ato në mënyrë të qartë, në një rend kronologjik dhe logjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtarja ka konkluduar lidhur me provueshmërinë e fakteve konkrete. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtares lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes. Ndërsa në vendimet me objekt (*dërgim çështje ne gjyq*) rrethanat janë të parashtruara në nënndarjen e titulluar “Rezultatet e hetimit paraprak”.

#### **- Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes**

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Gjyqtarja, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi, njohje e vërtetësisë së dokumentit, kundërshtim veprimesh përmbartimore*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën procedohet në çështjet penale, apo seancën paraprake nëse jemi para një kërkesë dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtares, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, posaçërisht në çështjet civile, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Gjyqtarja identifikon natyrën civile-familjare të çështjes duke e cituar atë në pjesën hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, si dhe duke analizuar natyrën e mosmarrëveshjes në kuadër të juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës<sup>2</sup>.

*Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm*, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar ligjin e zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

#### ***Sa i përket ligjit procedural:***

*Në çështjet familjare*, gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë

- Citon nenet 36/1, 41, 51 dhe 59/1 të K. Pr. Civile në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, nenet 25 dhe 158/b të K. Pr. Civile dhe 134 të K. Familjes në lidhje seancën e pajtimit, nenin 1 të K. Familjes në lidhjes me parimet bazë mbi të cilat funksionon martesë
- nenin 224/a të K. Pr. Civile në lidhje me caktimin e ekspertit.
- nenin 143 të K. Familjes në lidhje me dërgimin e vendimit të formës së prerë për regjistrim pranë Zyrës së Gjendjes Civile përkatëse, si dhe nenin 155 të K. Familjes dhe nenin 224/a të K. Pr. Civile në lidhje me caktimin e ekspertit.
- si dhe nenin 155 të K. Familjes dhe nenin 224/a të K. Pr. Civile në lidhje me caktimin e ekspertit

Në çështjet me objekt *lëshim urdhër ekzekutimi*, gjyqtarja:

- Identifikon natyrën civile të çështjes, duke e cituar në pjesën hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, si dhe duke zhvilluar analizën e juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës citon nenet 36/1, 41, 59/1 dhe 511 të K. Pr. Civile në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, nenin 510 të K. Pr. Civile në lidhje me titujt ekzekutivë, nenin 511 të K. Pr. Civile në lidhje me urdhrin e ekzekutimit. (*vendimet nr. 55-2020-1343, datë 18.12.2020 dhe nr. 55-2022-622, datë 30.06.*)

Në çështjet me objekt: (*përmbushje detyrimi; njohje vjetërsie në punë dhe vërtetësisë së dokumentit; pavlefshmëri titulli ekzekutiv.*<sup>3</sup> gjyqtarja:

- Identifikon natyrën civile të çështjes, duke analizuar natyrën e mosmarrëveshjes në kuadër të juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës, si dhe/ose përmes sqarimit të natyrës së padisë<sup>4</sup>.
- Citon nenet 6, 16 dhe 28 të K. Pr. Civile në lidhje me kufijtë e shqyrtimit prej gjykatës dhe parimin e disponibilitetit, nenin 35 të K. Pr. Civile në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, nenet 71-73 të K. Pr. Civile në lidhje me pajtueshmërinë

---

<sup>2</sup> Vendimet nr. 55-2022-1030/153, datë 15.12.2022, nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021.

<sup>3</sup> Me të cilin është disponuar për pushimin e gjykimit si padi që nuk mund të ngrihet.

<sup>4</sup> vendimet nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020, nr. 55-2021-1194/186, datë 28.10.2021 dhe nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022

e trupit gjykues, nenet 36, 41, 43, 54 dhe 59 të K. Pr. Civile në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës,

- Citon nenin 6/1 të KEDNJ dhe nenin 42 të Kushtetutës në lidhje me procesin e rregullt, nenin 41 të K. Pr. Civile dhe nenet 2 dhe 7 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës, si dhe nenin 61 të K. Pr. Civile në lidhje me dërgimin e çështjes pranë gjykatës kompetente
- nenet 2, 6, 14, 16 dhe 28 të K. Pr. Civile në lidhje me kufijtë e shqyrtimit prej gjykatës dhe parimin e disponibilitetit, nenet 33 dhe 91 të K. Pr. Civile në lidhje me zotësinë e palëve në proces, nenin 58 të K. Pr. Civile në lidhje me gjyqvarësinë, nenin 127 të K. Pr. Civile në lidhje me vendimet jo përfundimtare, nenin 184 të K. Pr. Civile në lidhje me legjitimimin procedural, nenin 153 të K. Pr. Civile në lidhje me hartimin e kërkesëpadisë, nenin 158a/2 pika (e) të K. Pr. Civile në lidhje me pushimin e gjykimit gjatë veprimeve paraprake, nenin 299 dhe 300 të K. Pr. Civile në lidhje me vendimin e pushimit dhe efektet e tij, dhe nenet 442/a dhe 443 të K. Pr. Civile në lidhje me ankimin.

***Sa i përket ligjit material të zbatueshëm***, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në vendimet gjyqësore objekt vlerësimi (*me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj , përmbushje detyrimi; njohje vjetërsie në punë dhe vërtetësisë së dokumentit; pavlefshmëri titulli ekzekutiv, etj.*) gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Familjes, ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, kryesisht:

Në çështjet me objekt “*Zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj*”, Gjyqtarja citon:

- nenin 132 të K. Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort, nenin 146 të K. Familjes në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve
- nenet 155, 157, 158, 161, 197, 201 dhe 215 të K. Familjes në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore,
- nenin 3 dhe nenin 12 të Konventës “*Për të drejtat e fëmijëve*” në lidhje me interesin më të lartë të fëmijës, nenet 36/1, 41, 51 dhe 59/1 të K. Pr. Civile në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, nenet 25 dhe 158/b të K. Pr. Civile dhe 134 të K. Familjes në lidhje seancën e pajtimit, nenet 2, 5 dhe 6 të K. Familjes në lidhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës, nenin 123 të K. Familjes në lidhje me mbarimin e martesës, nenin 125 dhe 127 të K. Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok,

Në çështjet me (*me objekt lëshim urdhër ekzekutimi*), gjyqtarja identifikon:

- nenin 511 të K. Pr. Civile në lidhje me urdhrin e ekzekutimit, ligjin nr. 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore të ujit të pijshëm si titull ekzekutiv” të ndryshuar në lidhje me faturën tatimore të ujit të pijshëm titull ekzekutiv, si dhe ligjin 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, përkatësisht nenin 2 të tij në lidhje me fushë e zbatimit.

Në çështjet me *objekt: përmbushje detyrimi; njohje vjetërsie në punë dhe vërtetësisë së dokumentit; pavlefshmëri titulli ekzekutiv*), gjyqtarja identifikon dhe citon:

- nenin 450 të K. Civil në lidhje me kamatat ligjore, nenin 655 dhe 658 të K. Civil në lidhje me padinë e begatimit pa shkak, si dhe nenin 698 të K. Civil në lidhje me shpërblimin e dëmit (*vendimi nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020*);
- nenin 299 dhe 300 të K. Pr. Civile në lidhje me vendimin e pushimit dhe efektet e tij, identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale (nenin 609 të K.Pr.Civile), në lidhje me normën ligjore të zbatueshme për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv në funksion të analizës lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes (*vendimi nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022*).
- nenin 246 të K. Pr. Civile në lidhje me fuqinë provuese të provës me shkresë, nenet 253-255 të K. Pr. Civile në lidhje me aktet zyrtare dhe fuqinë provuese të tyre, si dhe ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

#### **Sa i përket ligjit procedural:**

*Në çështjet penale themeli dhe kërkesa penale, konkretisht me objekt: “Dërgim në gjyq dhe pushim, zgjerimin e ekstradimit, pushimin e procedimit penal si dhe gjykim për veprën penale të parashikuar përkatësisht nga: neni 199/a/1 i K. Penal; neni 236/2 i K. Penal; neni 297 i K. Penal; neni 291 i K. Penal,”* gjyqtarja identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë:

- Citon nenin 59 të K. Pr. Penale në lidhje me viktimën akuzuese, nenin 79/1/b të K. Pr. Penale në lidhje me rastet e bashkimit të procedimeve , nenin 331 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, nenin 332/ë të K. Pr. Penale në lidhje me fashikullin e gjykimit, nenin 332/dh të K. Pr. Penale në lidhje me vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake, (*vendimi nr. 237, datë 18.05.2020*);
- nenin 260 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, nenin 237 të K. Pr. Penale në lidhje me masën e sigurimit “*Arrest në shtëpi*”, nenin 238 të K. Pr. Penale në lidhje e masën e sigurimit “*Arrest në burg*”, nenin 323 të K. Pr. Penale në lidhje me afatin e hetimeve paraprake, nenin 324 të K. Pr. Penale në lidhje me zgjatjen e afatit të hetimeve, nenin 327 të K. Pr. Penale në lidhje me veprimet e policisë gjyqësore dhe të prokurorit në përfundim të hetimeve paraprake, (*vendimi nr. 20, datë 11.01.2021*).
- Citon nenet 69, 74 dhe 76 të K. Pr. Penale në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës, nenin 128 të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë absolute, nenin 332/c/3, 332/dh dhe 405 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar, nenin 190 të K. Pr. Penale në lidhje me disponimin për provat materiale, nenin 485/3 të K. Pr. Penale në lidhje me shpenzimet procedurale, nenin 47 të K. Penal në lidhje me mënyrën e caktimit të dënimit, nenin 48 dhe 49 të K. Penal në lidhje me

rrethanat lehtësuese, nenin 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, (vendimin nr. 136, datë 09.06.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, (vendimi nr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021);

- Citon nenin 13/2/c të K. Pr. Penale në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, nenet 69, 74, 76 dhe 329/a të K. Pr. Penale në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, nenet 328/1 dhe 329/a të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës ose çështjes, nenin 66 të K. Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale,<sup>5</sup>
- nenin 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë, (vendimi nr. 55-2020-546/79, datë 18.06.2020);
- Citon nenin 128 të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë absolute, nenet 332/c/3, 332/dh dhe 405 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar, nenin 485 të K. Pr. Penale në lidhje me shpenzimet procedurale

### **Sa i përket ligjit material:**

- nenin 92 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Plagosja e lehtë nga pakujdesia”, si dhe nenin 278 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”(vendimi nr. 237, datë 18.05.2020);
- nenin 298 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” (vendimi nr. 20, datë 11.01.2021).
- nenin 53 të Kodit Penal Gjerman në lidhje me veprën penale “Trafikimi i narkotikëve »
- nenin 39 të Kushtetutës dhe nenin 11 të K. Penal në lidhje me ekstradimin, nenet 489-491 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për ekstradim, kushtet për ekstradim dhe për mospranimin e tij, nenin 501 të K. Pr. Penale në lidhje me zgjerimin e ekstradimit, Ligji me nr.10193 date 03.12.2009 « Për marrëdhëniet Juridiksionale me Autoritet e huaja ne Çështjet Penale »
- nenin 283/a/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, si dhe ligjet nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. vendimin nr. 136, datë 09.06.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës,
- nenin 152 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Shkatërrimi i pronës me eksploziv” (vendimi nr. 55-2020-599, datë 29.06.2020);
- nenin 99 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Shkaktimi i vetëvrasjes” (vendimi nr. 55-2020-1293, datë 28.12.2020);
- nenin 290/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” (vendimi nr. 55-2021-987, datë 27.09.2021);
- nenin 134/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhja” (vendimi nr. 55-2022-183, datë 21.02.2022).

---

<sup>5</sup> vendimet nr. 55-2020-599, datë 29.06.2020, nr. 55-2020-1293, datë 28.12.2020, nr. 55-2021-987, datë 27.09.2021 dhe nr 55-2022-183, datë 21.02.2022 (vendimi nr. 55-2020-1293, datë 28.12.2020); (vendimi nr. 55-2021-987, datë 27.09.2021); (vendimi nr. 55-2022-183, datë 21.02.2022). Në vendimet nr. 55-2020-1256, datë 22.12.2020, nr. 55-2020-114, datë 23.01.2020, nr. 55-2020-585, datë 25.06.2020 dhe nr. 55-2022-306, datë 28.03.2022 të (vendimi nr. 55-2020-585, datë 25.06.2020)

- nenin 297 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, si dhe nenet 12 dhe 14 të ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” (vendimi nr. 55-2020-1256, datë 22.12.2020, nr. 55-2020-114, datë 23.01.2020 dhe nr. 55-2022-306, datë 28.03.2022);
- si nenin 291 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, (vendimi nr. 55-2020-585, datë 25.06.2020).
- nenin 199/a/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikim dhe zhvillimin e territorit” dhe VKM përkatëse (vendimi nr. 55-2020-546/79, datë 18.06.2020);
- nenin 236/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, ligjin nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, si dhe ligjin nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (vendimi nr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021);
- nenin 297 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, si dhe nenet 12 dhe 14 të ligjit nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” (vendimi nr. 55-2021-904/186, datë 14.09.2021);
- nenin 291 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” (vendimi nr. 55-2022-444/123, datë 16.05.2022).

*Sa i përket konfliktit të normave*, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

## **KONKLUZIONI**

*Në tërësi*, gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsytimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, dhe pikezohet me 25 pikë.



### ***1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.***

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Gjyqtarja i kushton vëmendje interpretimit të normave në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin duke i dhënë kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, në funksion të konkluzionit në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

#### ***- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Në vendimet civile dhe penale interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari:

-Analizon të drejtën e padisë referuar nenit 32/c të K.Pr.Civile. Në këtë kuadër, sqaron se gjykimi civil mbi vërtetësinë ose pavërtetësinë e një dokumenti është në themel gjykimi i një “padi njohje”, përmes së cilës konfirmohet në rrugë gjyqësore ekzistenca ose moskezistenca e një marrëdhënie juridike të materializuar në dokumentin shkresor objekt gjykimi. Gjithashtu, sqaron legjitimitimin aktiv dhe pasiv në gjykime të kësaj natyre.

-Në vendimet me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, gjyqtarja analizon verifikimin e zbatimit të ligjit të identifikuar, përkatësisht nenet 510 dhe 511 të K. Pr. Civile në lidhje me titujt ekzekutivë dhe lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, në faktet e çështjes objekt gjykimi.

#### ***Ne çështjet civile:***

- Analizon verifikimin e zbatimit të ligjit të identifikuar, përkatësisht nenet 510 dhe 511 të K. Pr. Civile në lidhje me titujt ekzekutivë dhe lëshimin e urdhrat të ekzekutimit, në faktet e çështjes objekt gjykimi
- Trajton institutin e begatimit pa shkak, duke u ndalur në kuptimin dhe kushtet e kërkuara nga ligji për verifikimin e tij. Në këtë kuadër, evidenton si kushte kumulative të tij: së pari, një person të jetë pasuruar dhe një tjetër të jetë dëmtuar; së dyti, pasurimi i një personi duhet të rrjedhë nga dëmtimi i personit tjetër; së treti, pasurimi nuk duhet të ketë ndodhur në bazë të një shkakut të ligjshëm (*vendim nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020*);
- Në vendimet me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, gjyqtarja: Citon dhe analizon parimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke mbajtur

në konsideratë parashikimet e K. Familjes, si dhe të Konventës “Për të drejtat e fëmijëve”.

- Analizon zbatueshmërinë e nenit 132 të K. Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort në rrethanat e çështjes objekt gjykimi, si dhe të dispozitave ligjore përkatëse në lidhje me pasojat e zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve dhe në lidhje me rregullimin e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore. (vendimi nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021);
- Citon dhe analizon parimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e K. Familjes, si dhe të Konventës “Për të drejtat e fëmijëve”. (vendimi nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021)

### ***Në çështjet penale :***

Në vendimin me objekt zgjerimin e ekstradimit gjyqtarja:

- Analizon institutin e zgjerimit të ekstradimit parashikuar nga neni 501 i K. Pr. Penale. Në këtë kuadër sqaron se referuar këtij neni, në rastin kur i ekstraduari i cili merret në pyetje nga shteti kërkues e pranon zgjerimin e ekstradimit, nuk zhvillohet gjykim. Ndërsa në rastin kur ai nuk e pranon, zhvillohet gjykim themeli dhe gjykata vlerëson nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për dhënien e ekstradimit për një veprë penale të ndodhur para dorëzimit, të ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi. Evidenton kushtet për lejimin e ekstradimit si dhe mospranimin e tij, të cilat janë të zbatueshme edhe për zgjerimin e ekstradimit, duke i zbërthyer ato në rrethanat konkrete të çështjes.

Në vendimin nr. 136, datë 09.06.2022 (me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/1 i K. Penal) gjyqtarja:

- Zhvillon analizën juridike të veprës penale “Trafikimi i narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/a/1 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të saj; Referon jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 në lidhje me gjykimin e shkurtuar.
- Analizon elementët e veprës penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” parashikuar nga neni 278 i K. Penal<sup>6</sup>

Në vendimet me objekt pushimin e procedimit penal, gjyqtarja:

Merr në analizë konceptin për përgjegjësinë penale. Në këtë kuadër, sqaron se e vetmja bazë për marrjen e një

---

<sup>6</sup> vendimi nr. 237, datë 18.05.2020.

<sup>7</sup> vendimi nr. 55-2020-1293, datë 28.12.2020, nr. 55-2021-987, datë 27.09.2021 ;

- bërë edhe referimin në ligjin e posaçëm nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” (vendimet nr. 55-2020-1256, datë 22.12.2020, nr. 55-2020-114, datë 23.01.2020 dhe nr. 55-2022-306, datë 28.03.2022).
- Analizon elementët e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K. Penal (vendimi nr. 55-2020-585, datë 25.06.2020).
- Analizon verifikimin e zbatimit të ligjit të identifikuar në faktet e çështjes objekt gjykimi (vendimet nr. 55-2020-1256, datë 22.12.2020, nr. 55-2020-114, datë 23.01.2020, nr. 55-2020-585, datë 25.06.2020 dhe nr. 55-2022-306, datë 28.03.2022).

Në vendimet me objekt gjykimin për veprën penale të parashikuar përkatësisht nga: neni 199/a/1 i K. Penal; neni 236/2 i K. Penal; neni 297 i K. Penal; neni 291 i K. Penal, gjyqtarja:

- Zhvillon analizën juridike të veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të saj (vendimi nr. 55-2020-546/79, datë 18.06.2020);
- Zhvillon analizën juridike të veprës penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të saj (vendimi nr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021);
- Zhvillon analizën juridike të veprës penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 297 i K. Penal, duke bërë edhe referimin në ligjin e posaçëm nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” (vendimi nr. 55-2021-904/186, datë 14.09.2021);
- Zhvillon analizën juridike të veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K. Penal, duke u ndalur në objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të saj (vendimi nr. 55-2022-444/123, datë 16.05.2022);
- Referon jurisprudencën Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 në lidhje me gjykimin e shkurtuar (vendimi nr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021, nr. 55-2021-904/186, datë 14.09.2021 dhe nr. 55-2022-444/123, datë 16.05.2022);
- Zhvillon analizën juridike të veprës penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror” parashikuar nga neni 297 i K. Penal, duke bërë edhe referimin në ligjin e posaçëm nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale civile dhe penale, gjyqtarja përgjithësisht i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të

---

<sup>8</sup> vendimi nr. 55-2021-987, datë 27.09.2021

procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh në kërkesat civile për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, apo në çështjen civile. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja:

- Analizon kompetencën lëndore në kuptimin e përgjithshëm, duke u ndalur në kuptimin dhe rëndësinë e saj. Gjithashtu, evidenton elementët që duhet të analizohen për përcaktimin e kompetencës lëndore: a) objekti i padisë b) shkaku i padisë (*vendim nr. 55-2021-1194/186, datë 28.10.2021*);
- Analizon të drejtën e padisë referuar nenit 32/c të K. Pr. Civile. Në këtë kuadër, sqaron se gjykimi civil mbi vërtetësinë ose pavërtetësinë e një dokumenti është në themel gjykimi i një “*padi njohje*”, përmes së cilës konfirmohet në rrugë gjyqësore ekzistenca ose moskezistenca e një marrëdhënie juridike të materializuar në dokumentin shkresor objekt gjykimi. Gjithashtu, sqaron legjitimitimin aktiv dhe pasiv në gjykime të kësaj natyre.
- Trajton “*paditë që nuk mund të ngrihen*”, kuptimin dhe rastet përkatëse, duke evidentuar edhe praktikën e Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 139, datë 03.03.2021 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në kuadër të këtyre padive, ndalet në trajtimin e rastit të litispëndencës apo gjyqvarësisë, parashikuar nga neni 58 i K. Pr. Civile, për të cilën sqaron kuptimin dhe pasojat përkatëse (*vendimi nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022*);
- Citon dhe aplikon parimet e ligjshmërisë dhe disponibilitetit (*vendimet nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020 dhe nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022*), si dhe parimin e ndalimit të gjykimit më shumë se një herë të së njëjtës çështje (*vendimi nr. nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022*);
- Analizon institutin e zgjerimit të ekstradimit parashikuar nga neni 501 i K. Pr. Penale. Në këtë kuadër sqaron se referuar këtij neni, në rastin kur i ekstraduari i cili merret në pyetje nga shteti kërkues e pranon zgjerimin e ekstradimit, nuk zhvillohet gjykim. Ndërsa në rastin kur ai nuk e pranon, zhvillohet gjykim themeli dhe gjykata vlerëson nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për dhënien e ekstradimit për një vepër penale të ndodhur para dorëzimit, të ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi. Në vendimin nr. 178, datë 21.02.2022 (me objekt zgjerimin e ekstradimit) gjyqtarja.
- Trajton rolin dhe rëndësinë e gjyqtarit të seancës paraprake. Gjithashtu, trajton aspektin procedural të zhvillimit të seancës paraprake referuar parashikimeve të K. Pr. Penale, duke evidentuar elementët që duhet të merren në shqyrtim nga gjykata në gjykime të kësaj natyre dhe përkatësisht: nëse konstatohet ndonjë pavlefshmëri absolute e akteve procedurale; ekzistenca e përgjegjësisë penale dhe cilësimi juridik i faktit; kërkesa për gjykim të shkurtuar; si dhe përmbajtja e fashikullit të gjykimit (*vendimet nr. 55-2020-1256, datë 22.12.2020, nr. 55-2020-114, datë 23.01.2020, nr. 55-2020-585, datë 25.06.2020 dhe nr. 55-2022-306, datë 28.03.2022; vendimet nr. 237, datë 18.05.2020 dhe nr. 20, datë 11.01.2021*).

***Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante***, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet Unifikues të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e Kolegjit Civil, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Konkretisht, identifikohet:

- Referon jurisprudencën Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 në lidhje me gjykimin e shkurtuar.
- Referon nenin 3 dhe nenin 12 të Konventës “Për të drejtat e fëmijëve” në lidhje me interesin më të lartë të fëmijës,
- Citon nenin 6/1 të KEDNJ dhe nenin 42 të Kushtetutës në lidhje me procesin e rregullt ligjorë,
- Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 3/2012 në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatave administrative
- Referon jurisprudencën e Gjykatës Kushtetutës, përkatësisht vendimet nr. 23/2009, nr. 7/2009, nr. 31/2005 dhe nr. 16/2012 në lidhje me kompetencën si element i procesit të rregullt ligjor
- Referon jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 3/2012 në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatave administrative
- Referon jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, përkatësisht vendimin nr. 00-2020-797, datë 16.11.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjeve me objekt sipas nenit 32/c të K. Pr. Civile
- Konventën Evropiane të Ekstradimit të vitit 1957 dhe protokollet shtesë të saj,

***Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtarja njih, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e ligjshmërisë* në kuadër të rëndësisë që kane konstatimi i elementeve të figurës së veprës penale ;<sup>9</sup>
- *Parimet e ligjshmërisë dhe disponibilitetit si dhe parimin e ndalimit të gjykimit më shumë se një herë të së njëjtës çështje*<sup>10</sup>
- *Parimin e interesit më të lartë të të miturit* në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës;<sup>11</sup>
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor* nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile (*nenet 14 dhe 16 të K.Pr.Civile*);<sup>12</sup>
- *Parimin procedural të barrës së provës*, në funksion të vlerësimit të fakteve që shërbejnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

## **KONKLUZIONI**

<sup>9</sup> Vendimi nr.1293 date 28.12.2020

<sup>10</sup> vendimet nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020 dhe nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022

<sup>11</sup> vendimi nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021

<sup>12</sup>Vendimet civile burim vlerësimi.

*Në tërësi*, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar plotësisht dhe duke zbërthyer në elementët përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës, para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes konkrete. Po ashtu gjyqtarja, tregon një kujdes të veçantë për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore Unifikues, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e saj lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

## **1.B Arsyetimi ligjor**

### ***1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parime vete përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine,<sup>13</sup> përgjithësisht të etiketuar (në kllapa), duke u shoqëruar gjithnjë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe. Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare me objekt zgjidhje martesë, evidentohet që gjyqtarja pasqyron në mënyrë të përmbledhur duke treguar kujdes për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët në lidhje me shkaqe që çojnë drejt zgjidhjes së martesës, kjo pasi i jep rendësi respektimit të parimit të interesit më të lartë

<sup>13</sup> Për shembull : “de jure; litispendentia; apriori; ne bis in idem; prima facie”;etj

të fëmijës dhe respektimit të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit<sup>14</sup>.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, gjithsesi kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë elementët proceduralë, si: kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet respektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja. Pothuajse në të vendimet e analizuara evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbrëthimin e dispozitave të cituara (*Vlerësimi i gjykatës*). Kjo e bën vendimin me të qartë, të plotë dhe gjithëpërfshirës.

## **KONKLUZIONI**

*Në tërësi*, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i kushtuar rëndësi dhe peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

---

<sup>14</sup> Vendimi nr. 173 date 19.01.2020, vendimi nr. 88 date 21.07.2022, vendimi nr. 153 date 15.12.2022, vendimi nr. 207 date 22.11.2021, vendimi nr. 215 date 06.12.2021

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit “është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.***

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë në përmbyllje procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtarja ndjek metodologji përgjithësisht të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuar me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*padisë ose kërkesës në çështjet civile dhe objekti i kërkesës në çështjet penale*), si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesa përshkuese-arsyetuese* është e ndarë në disa pjesë të listuara formalisht me tituj, si: procedura, rrethanat e faktit/rezultatet e hetimeve paraprake dhe pretendimet e palëve, vlerësimi i gjykatës, në të cilën në mënyrë të detajuar analizon: (i) elementët proceduralë të vlerësuar nga gjykata (juridiksioni, kompetenca), vlerësimi për kërkesat procedurale të palëve, së bashku me argumentet për vendimmarrjen respektive të gjykatës lidhur me to; (ii) faktet thelbësore të çështjes objekt shqyrtimi, dhe pretendimet e palëve gjatë gjykimit, (iii) vlerësimi i gjykatës, në të cilin merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale, por edhe ato të ligjit të posaçëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe (iv) konkluzion mbi çështjen, ky i fundit në pjesën me të madhe të vendimeve është i pozicionuar direkt pas titullit “*Vlerësimi i gjykatës*”.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi : (i) çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (pranimin /rrezimin e kërkesë padisë apo pushimin ), (ii) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor apo të pafajshëm*), apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (dërgimin në gjyq, deklarimin e moskopesencës apo pushimin e procedimit penal), (iii) dënimin dhe masën



e dënimit, (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vi) disponimi mbi provat materiale dhe (vii) shpenzimet gjyqësore, në çështjet civile/penale.

Përgjithësisht vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligji i zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjyqtarja. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit.

## **KONKLUZIONI**

*Në tërësi*, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### ***1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:***

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezultojnë një nivel shumë i mirë arsyetimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore,<sup>15</sup> përcaktimit të barrës së provës, rolit të gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë, etj.

---

<sup>15</sup>Te gjitha vendimet vendimet civile burim vlerësimi.

Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ka zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore të provave të administruara në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim, për të vijuar më pas me aplikimin e ligjit mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja tregon kujdes në arsyetim dhe mënyrën e organizimit të tij, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj në themel.

### ***Ne vendimet civile burim vlerësimi :***

Gjyqtarja në vendimet burim vlerësimi fillimisht merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, vendimi trajton natyrën e padisë së njohjes, duke sqaruar se përmes saj konfirmohet në rrugë gjyqësore ekzistenca ose mosekzistenca e një marrëdhënie juridike të materializuar në dokumentin shkresor objekt gjykimi. Gjithashtu, vendimi sqaron edhe legjitimitimin procedural, si dhe mjetet provuese në gjykime të kësaj natyre. Në vijim, evidentohet përmbajta e neneve 246 dhe 253 të K. Pr. Civile, në lidhje me fuqinë provuese të shkresave dhe akteve zyrtare. Mbi këtë bazë, zhvillohet analiza e rrethanave konkrete të çështjes dhe konkludohet mbi vërtetësinë e të dhënave të pretenduara prej paditëses, e për pasojë në lidhje me çështjen objekt gjykimi.<sup>16</sup>

- Sa i përket çështjeve *me objekt përmbushje detyrimi; njohje vjetërsie në punë dhe vërtetësisë së dokumentit; pavlefshmëri titulli ekzekutiv*<sup>17</sup>. Evidentohen në varësi të padisë në gjykim, përkatësisht: padia e begatimit pa shkak dhe kushtet ligjore në kuadër të saj<sup>18</sup>; koncepti i kompetencës lëndore, elementët për identifikimin e saj dhe rëndësia e saj në kuadër të procesit të rregull, duke sjellë në vëmendje edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese<sup>19</sup>; koncepti i litispencës, elementët që duhet të shqyrtohen për verifikimin e saj, si dhe pasoja përkatëse<sup>20</sup>. Në vijim, analizohen rrethanat konkrete të kërimit/rrethanat procedurale, përkatësisht: verifikimi i kushteve ligjore për të qënë para begatimit pa shkak, si dhe kamatat ligjore referuar nenit 450 të K. Civil<sup>21</sup>; objekti dhe shkak ligjor i kërimit për të përcaktuar natyrën e vërtetë të tij<sup>22</sup>; objekti, shkak dhe palët ndërgjyqëse në padinë objekt gjykimi krahasuar me objektin, shkakun dhe palët ndërgjyqëse në vendimin e paraqitur nga pala e paditur për të vërtetuar rrethanën e litispencës<sup>23</sup>. Mbi këtë bazë konkludohet në lidhje me: zgjidhjen e çështjes<sup>24</sup>; deklarin e moskompetencës së saj dhe dërgimin e akteve pranë gjykatës kompetente për vijimin e gjykimit<sup>25</sup>; verifikimin e litispencës dhe rrjedhimisht pushimin e gjykimit<sup>26</sup>
- Sa i përket vendimeve me objekt *(me objekt lëshim urdhër ekzekutimi)* në këto vendimet gjyqësore fillimisht identifikojnë ligjin e zbatueshëm në kuadër të verifikimit të titullit ekzekutiv të pretenduar. Mbi këtë bazë, në vendimin nr. 55-2020-1343, datë 18.12.2020 verifikohet nëse faturat tatimore të ujit të pijshëm përbëjnë titull ekzekutiv dhe

<sup>16</sup> Vendimi nr. 40, datë 18.02.2020

<sup>17</sup> vendimet nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020, nr. 55-2021-1194/186, datë 28.10.2021 dhe nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022)

<sup>18</sup> vendimi nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020

<sup>19</sup> vendimi nr. 55-2021-1194/186, datë 28.10.2021)

<sup>20</sup> vendimi nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022)

<sup>21</sup> vendimi nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020))

<sup>22</sup> vendimi nr. 55-2021-1194/186, datë 28.10.2021)

<sup>23</sup> vendimi nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022)

<sup>24</sup> vendimi nr. 55-2020-1292/223, datë 28.12.2020)

<sup>25</sup> vendimi nr. 55-2021-1194/186, datë 28.10.2021)

<sup>26</sup> vendimi nr. 55-2022-480/62, datë 26.05.2022).

plotësohen kushtet për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Në këtë kuadër, sqarohet se faturat tatimore të ujit të pijshëm përbëjnë titull ekzekutiv dhe duhet të lëshohet urdhri i ekzekutimit vetëm në vlerën nominale të tyre, ndërkohë, sa i përket pjesës së kamatave ligjore, ato nuk përbëjnë titull ekzekutiv. Ndërsa, në vendimin nr. 55-2022-622, datë 30.06.2022 verifikohet nëse kontrata e huasë lidhur me subjektin financiar jobankar përbën titull ekzekutiv dhe plotësohen kushtet për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit. Në përfundim, në varësi të bazueshmërisë së kërkesave të paraqitura, konkludohet përkatësisht për pranimin e pjesëshëm apo pranimin tërësor të kërkesës.

- Në çështjet familjare (me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të rrjedhura prej saj) Vendimet gjyqësore fillimisht pasqyrojnë përmbajtjen e nenit përkatës të K. Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës, respektivisht: nenit 132 të K. Familjes, në lidhje me zgjidhjen e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort 27 dhe nenit 125 të K. Familjes në lidhje me zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok 28. Mbi këtë bazë, duke sjellë në vëmendje rrethanat e çështjes objekt gjykimi, si dhe duke zhvilluar analizën e tyre, konkludohet për përmbushjen e kushteve ligjore për zgjidhjen e martesës. 29 Rrjedhimisht vijohet me rregullimin e pasojave të zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve dhe në lidhje me fëmijët. Sa i takon rregullimit të pasojave të zgjidhjes së martesës ndërmjet bashkëshortëve, trajtohet ajo e parashikuar nga neni 146 i K. Familjes, pra në lidhje me mbajtjen ose jo të mbiemrit të fituar me lidhjen e martesës. 30 Sa i takon pasojave të zgjidhjes së martesës në lidhje me fëmijën, duke mbajtur në konsideratë parimin e interesit më të lartë të fëmijës, vendimet analizojnë dhe konkludojnë në lidhje me: lënien e fëmijës për rritje dhe edukim; përcaktimin e modaliteteve të ushtrimit të së drejtës së takimit; si dhe detyrimin për ushqim. 31 Në përfundim, referuar nenit 143 të K. Familjes, përcaktohet se një kopje e vendimit pasi të ketë marrë formë, dërgohet për regjistrim pranë Zyrës së Gjendjes Civile përkatëse për të bërë ndryshimet e nevojshme në përputhje me vendimin gjyqësor.

### ***Në çështjet penale themeli :***

- *Gjyqtarja në vendimet penale fillimisht merr në analizë veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjen objekt gjykimi, përkatësisht: veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i K. Penal,<sup>32</sup> ; veprën penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, parashikuar nga neni 236/2 i K. Penal,<sup>33</sup>;veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”, parashikuar nga neni 297 i K. Penal,<sup>34</sup> ; veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i K. Penal,<sup>35</sup>. Paralelisht me analizën juridike, zhvillohet edhe analiza e secilit prej elementëve të kësaj vepre penale, duke konkluduar në këtë mënyrë për përgjegjësinë penale të të pandehurit, konkretisht për fajësinë e tij për shkak të verifikimit të katër elementëve të veprës penale. Në vijim, analizohet dënimi*

---

27 vendimet nr. 55-2022-1030/153, datë 15.12.2022, nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021)

28. vendimi nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020)

29 vendimet nr. 55-2022-1030/153, datë 15.12.2022, nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021)

30 (vendimet nr. 55-2022-1030/153, datë 15.12.2022, nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021)

31 vendimet nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021

32 vendimi nr. 55-2020-546/79, datë 18.06.2020

33 vendimi nr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021

34 vendimi nr. 55-2021-904/186, datë 14.09.2021

35 vendimi nr. 55-2022-444/123, datë 16.05.2022

dhe elementët që duhet të mbahen parasysh në caktimin e tij<sup>36</sup>. Gjithashtu, analizohet edhe mundësia e aplikimit të nenit 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, nisur nga kërkesa e të pandehurit apo kryesisht nga gjykata, kur është rasti referuar rrethanave të çështjes<sup>37</sup>. Së fundi, vendimet disponojnë në lidhje me mënyrën e vuajtjes së dënimit<sup>38</sup>, si dhe shpenzimet procedurale, referuar nenit 485 të K. Pr. Penale<sup>39</sup>

- Në çështjet me *(me objekt dërgim në gjyq dhe pushim)*. Në këtë kuadër, analizohet roli dhe rëndësia e gjyqtarit të seancës paraprake. Gjithashtu, analizohet aspekti procedural i zhvillimit të seancës paraprake referuar parashikimeve të K. Pr. Penale, duke theksuar elementët që duhet të merren në shqyrtim nga gjykata në gjykime të kësaj natyre dhe përkatësisht: nëse konstatohet ndonjë pavlefshmëri absolute e akteve procedurale; ekzistenca e përgjegjësisë penale dhe cilësimi juridik i faktit; kërkesa për gjykim të shkurtuar; si dhe përmbajtja e fashikullit të gjykimit. Në vijim, evidentohen elementët e veprës penale në themel të kërkesës objekt gjykimi, përkatësisht veprës penale parashikuar nga neni 278 i K. Penal *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit”*. Ndërkohë, sqarohet se në lidhje me veprën tjetër penale *“Plagosja e lehtë nga pakujdesia”*, parashikuar nga neni 92 i K. Penal, kjo akuzë duhet pushuar pasi referuar nenit 59 të K. Penal, ajo ndiqet me ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë nga viktimja akuzuese, e cila nuk ka bërë ankim. Më tej, duke marrë në analizë çështjen objekt gjykimi, konstatohet se janë paraqitur prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën, e cila është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, si dhe cilësimi juridik i faktit penal është i drejtë. Gjithashtu, evidentohet se nga mbrojtja nuk u paraqitën kërkesa për pavlefshmëri apo papërdorshmëri. Mbi këtë bazë, duke pasqyruar edhe përmbajtjen e fashikullit të gjykimit, konkludohet për dërgimin e çështjes në gjyq<sup>40</sup>. Po te njëjtën linjë cilësi analize dhe argumentimi logjik ka ndjekur ne te gjitha vendimet te kësaj natyre me objekt ( dërgim ne gjyq)<sup>41</sup>
- Në çështjen *(me objekt zgjerimin e ekstradimit)*, analizohet instituti i zgjerimit të ekstradimit parashikuar nga neni 501 i K. Pr. Penale, duke sqaruar se referuar këtij neni, në rastin kur i ekstraduari i cili merret në pyetje nga shteti kërkues e pranon zgjerimin e ekstradimit, nuk zhvillohet gjykim. Ndërsa në rastin kur ai nuk e pranon, zhvillohet gjykim themeli dhe gjykata vlerëson nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për dhënien e ekstradimit për një vepër penale të ndodhur para dorëzimit, të ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë ekstradimi. Gjithashtu, evidentohen kushtet për lejimin e ekstradimit si dhe mospranimin e tij, referuar neneve 490 dhe 491 të K. Pr. Penale, duke theksuar se ato janë të zbatueshme edhe për zgjerimin e ekstradimit, të cilat më pas zbërthehen në rrethanat konkrete të çështjes. Referuar kësaj analize, konkludohet për lejimin e zgjerimit të objektit të ekstradimit me kusht të shprehur se i ekstraduari nuk do të ndiqet, nuk do të dënohet dhe as do të dorëzohet një shteti tjetër për një vepër penale që ka ndodhur para kërkesës për dorëzim dhe që është e ndryshme nga ajo për të cilën është dhënë zgjerimi ekstradimi

---

36 vendimet nr. 55-2020-546/79, datë 18.06.2020, nr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021, nr. 55-2021-904/186, datë 14.09.2021 dhe nr. 55-2022-444/123, datë 16.05.2022

37 (vendimi nr. 55-2020-546/79, datë 18.06.2020, nr. 55-2021-904/186, datë 14.09.2021 dhe nr. 55-2022-444/123, datë 16.05.2022

38 vendiminr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021

39 vendimet nr. 55-2020-546/79, datë 18.06.2020, nr. 55-2021-1071/240, datë 07.10.2021, nr. 55-2021-904/186, datë 14.09.2021 dhe nr. 55-2022-444/123, datë 16.05.2022

40 Vendimi nr. 20, datë 11.01.2021

41 Vendimet nr. 55-2020-1256, datë 22.12.2020, nr. 55-2020-114, datë 23.01.2020, nr. 55-2020-585, datë 25.06.2020 dhe nr. 55-2022-306, datë 28.03.2022

- Në çështjet penale me *(me objekt pushimin e procedimit penal)*. Vendimet gjyqësore fillimisht, referohen kërkesës së prokurorisë, identifikojnë dhe citojnë dispozitat përkatëse për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi. Konkretisht, identifikohen: neni 328/1/d dhe 329/a të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për pushimin e procedimit penal, neni 66/ç i K. Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale për veprat penale për të cilat parashikohet dënim deri në pesë vjet ose gjobë, si dhe neni 152/1 i K. Penal në lidhje me veprën penale “*Shkatërrimi i pronës me eksploziv*” (vendimi nr. 55-2020-599, datë 29.06.2020); neni 99 i K. Penal në lidhje me veprën penale “*Shkaktimi i vetëvrasjes*”, neni 328/1/b në lidhje me pushimin e akuzës ose çështjes kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, si dhe neni 329/b/3 në lidhje me pushimin e akuzës kur verifikohen rastet e nenit 328/1 (vendimi nr. 55-2020-1293, datë 28.12.2020); neni 290/2 i K. Penal në lidhje me veprën penale “*Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor*”, neni 328/1/b në lidhje me pushimin e akuzës ose çështjes kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, si dhe neni 329/b/3 në lidhje me pushimin e akuzës kur verifikohen rastet e nenit 328/1 (vendimi nr. 55-2021-987, datë 27.09.2021); nenet 328/1/d, 329/a dhe 329/b të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për pushimin e procedimit penal, neni 66/ç i K. Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale për veprat penale për të cilat parashikohet dënim deri në pesë vjet ose gjobë, si dhe neni 134/1 i K. Penal në lidhje me veprën penale “*Vjedhja*” (vendimi nr. 55-2022-183, datë 21.02.2022). Mbi këtë bazë, zhvillohet analiza e rrethanave të çështjes dhe përkatësisht: marzhi kohor nga data e kryerjes së veprës penale deri në rifillimin e hetimeve, prej nga konstatohet se kanë kaluar më shumë se pesë vjet dhe autori i kryerjes së veprës penale nuk është zbuluar (vendimi nr. 55-2020-599, datë 29.06.2020 dhe nr. 55-2022-183, datë 21.02.2022); rezultatet e aktit të ekspertimit prej të cilit evidentohet shkak i vdekjes së viktimës, për të konkluduar se kjo e fundit nuk plotëson elementët e ndonjë vepre penale (vendimi nr. 55-2020-1293, datë 28.12.2020); rezultatet e aktit të ekspertimit prej të cilit evidentohet plagosja e lehtë vetëm për një prej viktimave, e për pasojë konkludohet se nuk plotësohen elementët e ndonjë vepre penale (vendimi nr. 55-2021-987, datë 27.09.2021). Në përfundim, konkludohet në lidhje me verifikimin e kushteve për pushimin e procedimit penal dhe rrjedhimisht mbi bazueshmërinë e kërkesës.

***Në vendimet civile dhe penale burim vlerësimi*** gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve dhe koncepteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, p.sh:

- (i) Institutit të zgjidhjes së martesës dhe përcaktimit të përgjegjësisë prindërore, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët dhe fëmijët e mitur, duke u ndalur në këtë drejtim në pasojat në lidhje me mënyrën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore dhe ato me karakter material, analizë e cila mbështetet në çdo rast në parimin e interesit më të lartë të fëmijës;<sup>42</sup>
- (ii) *Institutin e zgjerimit te ekstradimit* ne rastin kur i ekstraduari i cili merret ne pyetje nga shteti kërkues e pranon zgjerimin e ekstradimit , nuk zhvillohet gjykim ne rast te kundërt zhvillohet gjykimi ne themel dhe vlerësohet nga gjykata nëse ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore për dhënien e ekstradimit për një vepër

<sup>42</sup> Vendimi nr. 17 date 09.01.2020 ,vendimi nr. 88 date 21.07.2022, vendimi nr. 207 date 22.11.2021 , vendimi nr. 215 date 06.12.2021, vendimi nr. 153 date 05.12.2022

penale te ndodhur para dorëzimit, te ndryshme nga ajo për te cilën e ekstradimi është dhënë,<sup>43</sup>

Siç konstatohet gjithashtu, gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë analizës së rrethanave dhe fakteve konkrete të çështjes në raport me elementët ligjorë të identifikuar referuar analizës së ligjit të zbatueshëm, si dhe prapësimeve procedurale/materiale të ngritura nga pala e paditur, për të konkluduar më pas në mënyrë logjike mbi bazueshmërinë ose jo të kërkimit të palëve.

*Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve*, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar pas pjesës *rrethanat e faktit* vijnë te integruara ne vendim dhe *pretendimet e palëve*, duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsytimit ligjor. Pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor.

## KONKLUZIONI

*Bazuar në sa më sipër*, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt- konkluzion-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtares në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë aplikim në rastin konkret. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

<sup>43</sup>Vendimi nr. 178 date 21.02.2022

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.*

## **2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.**

### **2.A.a Respektimi i afateve ligjore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjithsej 299 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare,” Çështje penale kundërvajtje” “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Seanca paraprake”, dhe “Kërkesa penale faza ekzekutimit të marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se:

Për vitin 2020, gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 156 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 57 jashtë këtij afati<sup>44</sup>.

Për vitin 2021, gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 35 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 4 jashtë këtij afati<sup>45</sup>.

Për vitin 2022, gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 108 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 24 jashtë këtij afati<sup>46</sup>.

Sa me sipër rezulton se gjyqtarja ka gjykuar 299 çështje për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, 85 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 214 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është

---

<sup>44</sup> Në përlllogaritjen e numrit total të çështjeve për të cilat parashikohet afat ligjor gjykimi, si dhe të atyre të gjykuara jashtë këtij afati është mbajtur në konsideratë se çështjet me objekt “Zëvendësim/Revokim mase sigurimi”, që i përkasin tabelës nr. 10, referuar nenit 260 të K. Pr. Penale, i cili ka parashikuar afatin 5 ditë të gjykimit, kategorizohen në çështje me afat ligjor dhe jo me afat standard minimal (sikurse është bërë shënimi në tabelë). Ndërkohë, çështja me objekt “Zgjerim ekstradimi”, që i përket tabelës nr. 12, referuar nenit 501 të K. Pr. Penale, kategorizohet në çështje me afat standard minimal dhe jo me afat ligjor (sikurse është bërë shënimi në tabelë).

<sup>45</sup> Në përlllogaritjen e numrit total të çështjeve për të cilat parashikohet afat ligjor gjykimi, si dhe të atyre të gjykuara jashtë këtij afati është mbajtur në konsideratë se çështjet me objekt “Zëvendësim/Revokim mase sigurimi”, që i përkasin tabelës nr. 10, referuar nenit 260 të K. Pr. Penale, i cili ka parashikuar afatin 5 ditë të gjykimit, kategorizohen në çështje me afat ligjor dhe jo me afat standard minimal (sikurse është bërë shënimi në tabelë).

<sup>46</sup> Në përlllogaritjen e numrit total të çështjeve për të cilat parashikohet afat ligjor gjykimi, si dhe të atyre të gjykuara jashtë këtij afati është mbajtur në konsideratë se: Çështjet me objekt “Zëvendësim/Revokim mase sigurimi”, që i përkasin tabelës nr. 10, referuar nenit 260 të K. Pr. Penale, i cili ka parashikuar afatin 5 ditë të gjykimit, kategorizohen në çështje me afat ligjor dhe jo me afat standard minimal (sikurse është bërë shënimi në tabelë).

- Çështjet me objekt “Shuarje mase sigurimi”, që i përkasin tabelës nr. 10, referuar nenit 261 të K. Pr. Penale i cili ka parashikuar afatin 48 orë të gjykimit, kategorizohen në çështje me afat ligjor dhe jo me afat standard minimal (sikurse është bërë shënimi në tabelë).
- Çështjet me objekt “Zgjatje afatit të paraburgimit”, që i përkasin tabelës nr. 10 (ndërkohë janë pasqyruar gabimisht në tabelën nr. 12) kategorizohen në çështje me afat ligjor.

Çështjet me objekt “Miratim/Zgjerim ekstradimi”, që i përkasin tabelës nr. 12, referuar nenit 488 e vijues të K. Pr. Penale, kategorizohen në çështje me afat standard minimal dhe jo me afat ligjor (sikurse është bërë shënimi në tabelë).

marrë në tejkalim të afatit ligjor (85 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (299 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 28.4 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

***Referuar vetëvlerësimin të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se:***

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Respektimi i afateve ligjore” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Për vitin 2020 rezulton që kam marrë në short 371 çështje të reja janë mbartur 155 çështje nga viti 2019, nga të cilat janë përfunduar në total 513 çështje gjyqësore. Rezulton se në vitin 2019 është shkarkuar nga detyra z. Isuf Shehu me vendim të KPK-se fakt i ndodhur në muajin Nëntor të vitit 2019. Çështjet e tij janë rishortuar dhe kam marrë në short më shumë se 50 çështje njëherësh. Në muajt mars 2020-qershor 2020 është pezulluar veprimtaria gjyqësore me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për shkak të pandemisë COVID-19. Në muajin korrik 2020 e në vijim kam qenë pothuajse me raporte të vazhdueshme për shkak të gjendjes sime shëndetësore (shtatëzani). Pra në një periudhë 1-vjeçare që ka përkuar me vitin e parë të punës në detyrën e gjyqtares, janë verifikuar gjithë këto rrethana të cila kanë sjellë një ngarkesë jonormale në punën time. Megjithatë vlerësohet se norma e shqyrtimit të çështjeve është shumë e lartë. Për vitin 2021 rezulton që kam marrë në short 206 çështje nga të cilat janë përfunduar 142 çështje gjyqësore, janë mbartur 8 çështje nga viti 2020, (ngarkesa ka qenë më e paktë këtë vit për shkak se kam qenë me leje lindje). Për vitin 2022 rezulton që kam marrë në short 398 çështje nga të cilat janë përfunduar 374 çështje gjyqësore, janë mbartur 63 çështje. Në vitin 2021 është transferuar në Gjykatën e Apelit Tiranë gjyqtarja Alma Ahmeti fakt i ndodhur në muajin Janar të vitit 2022. Çështjet e saj janë rishortuar dhe kam marrë në short më shumë se 30 çështje njëherësh. Vlerësoj se, në të gjitha çështjet gjyqësore ndjekja e procedurave për realizimin e njoftimeve mund të ndikojë në kohëzgjatjen e procesit, por kjo është një kërkesë e detyrueshme e ligjit që duhet zbatuar nga gjykata. Numri i çështjeve që mund të ketë kaluar afatin ligjor për përfundimin e gjykimit konsiderohet i vogël në raport me numrin çështjeve të shortuara dhe të gjykuara brenda periudhës objekt vlerësimi. Në çështjet penale faktorët që mund të kenë ndikuar në mos gjykimin brenda afatit ligjor nuk lidhet me sjelljen e gjyqtares, por janë të lidhur me: a) mungesën e prokurorit të çështjes për shkaqe të ndryshme pa të cilin nuk zhvillohet procesi sipas neni 128 të K.Pr.Penale; b) nuk realizohet njoftimi i palëve dhe dëshmitarëve për shkak të adresave apo moskonfirmimit nga posta apo oficerët e policisë gjyqësore; c) mungesës së palëve të tjera për shkaqe të arsyeshme apo të paarsyeshme por që duhet të ndërmerren hapa për deklarimin e mungesës, caktimin e një avokati kryesisht dhe marrjen e kohës për studimin e dosjes nga ky i fundit, me qëllim realizimin e një mbrojtje efektive; d) pamundësia për të caktuar një seancë tjetër sa më shpejt për shkak të ngarkesës në punë; e) pezullimi i gjykimit të çështjeve për shkak se i pandehuri nuk merr dijëni personalisht për zhvillimin e gjykimit sipas nenit 352 të K.Pr.Penale; f) bojkoti i seancave gjyqësore nga avokatët gjatë vitit 2022; g) trajnimet vazhduese në Shkollën e Magjistraturës, si dhe shkaqe të tjera objektive të pavarura nga vullneti i gjykatës. Gjithashtu vlerësoj se për këtë kriter gjatë periudhës objekt vlerësimi duhet mbajtur në konsideratë edhe funksionimi me organikë jo të plotë i gjykatës, ndikimi shumë i madh i pandemisë Covid-19, kjo për arsye se ka pasur një



numër shumë të lartë seancash gjyqësore që janë shtyrë për këtë shkak, pasi palët dërgonin raporte mjekësore në mënyrë të vazhdueshme. Nga ana tjetër viti 2021 dhe 2022 ka shënuar edhe ndryshime në përbërjen e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, ku është verifikuar një rast i procedimit penal të një prokurori dhe shkarkime nga KPK. Kjo ka sjellë si pasojë që seancat penale të shtyhen në mënyrë të vazhdueshme, për shkak të vonesës së shortimit të dosjeve tek prokurorët e tjerë dhe për shkak se prokurorët e rinj kërkonin kohë për të njohur me aktet.

Në çështjet civile, mendoj se duhet mbajtur parasysh dhe fakti se pas ndryshimeve të kryera me ligjin 38/2017, ku palët duhet të mbanin qëndrimet e tyre dhe të paraqisnin provat përkatëse dhe në shumë raste njoftimi i palës së paditur për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes është kryer me shpallje dhe përveç kohës së nevojshme që shpallja të qëndronte e afishuar, nga ana e gjykatës është llogaritur dhe afati kohor i lënë për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes. Këtu duhen mbajtur parasysh dhe vonesat që sillte mosnjoftimi i palës në adresën e dhënë dhe veprimet e gjykatës për të administruar adresën zyrtare të palës në mungesë, me qëllim njoftimin e saj me shpallje. Sa më lart, duke marrë në konsideratë natyrën e ndryshme të çështjeve, kompleksitetin, numrin e lartë të tyre gjatë periudhës së vlerësimit, mendoj se kam treguar aftësi shumë të mira organizative duke u përpjekur në çdo rast të gjykojë brenda një afati sa më të shkurtër çështjet gjyqësore që më janë ngarkuar përmes shortit elektronik. Në kuadër të një gjykimi të drejtë e të rregullt ligjor, për shkaqe dhe në rrethana të pavarura nga ana ime ndonjëherë gjykimi i çështjeve ka zgjatur përtej afatit orientues të përcaktuar nga KLGJ, megjithatë nga ana ime janë marrë të gjitha masat për t'i përfunduar çështje brenda afatit ligjor dhe afateve të vendosura nga KLGJ-ja. Krahas marrjes së masave për t'i përfunduar çështjet brenda afatit ligjor nga ana ime janë respektuar të gjitha dispozitat procedurale për realizimin e njoftimeve dhe dhënies së palëve të kohës së nevojshme për të realizuar një mbrojtje efektive."

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 85 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se:

- (i) në çështjet me objekt "Miratim Urdhri penal"<sup>47</sup> (çështje të pasqyruar në tabelën nr.9, viti 2020 ne nr. rendor 31), 1 prej tyre është gjykuar për 11 ditë, pra 1 ditë në tejkallim të papërfillshëm të afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 260 të K.Pr.Penale.
- (ii) në çështjet me objekt "Dërgim çështjes në gjyq", çështje të pasqyruara tek tabela nr. 11, viti 2020 për të cilat në neni 332, i K.Pr.Penale parashikohet afati 30 ditor i gjykimit, zbriten 14 çështje pasi rezulton se çështjet me nr. rendor 3, 26, 27, 28, 31, 32, 33, 55, 92, 93, 117, 130, 131,143, është janë çështje te cilat kanë përfunduar përkatësisht 31 ditë, 24 ditë, 20 ditë, 24 ditë, 24 ditë, 31 ditë, 28 ditë, 19 ditë, 33 ditë, 33 ditë, 29 ditë, 28 ditë, 31 ditë, 32 ditë, brenda afatit 30 ditësh pasi nga përlllogaritja e afateve të tyre, janë zbritur, 41 ditë të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të periudhës së pandemisë COVID 2019 me vendim të KLGJ-se nga data 10.03.2020-20.04.2020 (gjithsej 41 ditë), si dhe

<sup>47</sup>Çështja është regjistruar me datë 01.06.2020, dhe ka përfunduar me date 12.06.2020.

periudha e pushimeve vjetore te muajit gusht për gjyqësorin (*gjithsej 35dite*), siç për 6 çështje është tejkeluar afatin ligjor me vetëm nga 1-3 ditë, një tejkalim i papërfillshëm i afatit ligjor ;

(iii) në çështjet me objekt "*Dërgim çështje në gjyq*", për të cilat në neni 332 i K.Pr.Penale parashikohet afati 30 ditor i gjykimit, rezulton se çështjet me nr. rendor 3, tabela 11, viti 2021, ka përfunduar ne një afat gjykimi prej 32 ditësh , pra 2 ditë një tejkalim i papërfillshëm, duke konsideruar të përfunduar brenda afatit ligjor 30 ditor.

(iv) në çështjet me objekt "*Zëvendësim mase sigurimi*", për të cilat në neni 260 i K.Pr.Penale parashikohet afati 5 ditor i gjykimit, rezulton se çështjet me nr. rendor 30, tabela 10, viti 2022, ka përfunduar ne një afat gjykimi prej 6 ditësh pra 1 ditë, një tejkalim i papërfillshëm, duke konsideruar te përfunduar brenda afatit ligjor te parashikuar nga ligji.

Duke përjashtuar çështjet në të cilat afati ligjor është tejkeluar me një kohë relativisht të shkurtër (*1 deri në 2, 3 ditë*), si dhe çështjet në të cilat vonesa në shqyrtim ka ardhur edhe si pasojë e arsyeve te lartpërmendura, numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit rezulton të jetë 68 çështje. Për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (68 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (299 çështje), rezulton të jetë *22.7 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor*.

Kjo përqindje e çështjeve jashtë afatit ligjor, sipas Metodologjisë pikëzohet me 9 pikë. Në Metodologji, lidhur më këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: *kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës (për shkak te rishortimit te ngarkesës se gjyqtarit të shkarkuar nga detyra apo transferimit në gjykatë tjetër te gjyqtares AA) apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit*. Në rastin konkret, rezulton se (i) gjyqtarja ka gjykuar një numër tepër të lartë çështjesh konkretisht 1030 çështje penale dhe civile (gjithsej 299 çështje) për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi çka përben 33.7% të çështjeve në total gjithashtu kompleksitetit i çështjeve problematikat ne lidhje me njoftimin palëve. Duhet patur parasysh edhe fakti se pikërisht viti në të cilin gjyqtarja ka numrin me të madh të çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjorë përkon me periudhën për të cilën gjyqtarja ka deklaruar se ka qenë me raporte të vazhdueshme për shkak të gjendjes së saj shëndetësorë (shtatëzani), nga muaji korrik 2020 e në vijim 2021.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Duke iu referuar analizës matematikore e logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të analizuara më sipër si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares, vlerësoj se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes prej 22.7% të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit dhe që në rastin konkret përkon me 9 pikë. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e

proporcionalitetit dhe objektivitetit, përballë detyrueshmerisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Duke iu referuar numrit të madh të çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtarja gjithsej 1030 çështje për gjithë periudhën e vlerësimit, numri i çështjeve të shqyrtuara tej afatit ligjor përben vetëm 6 % të çështjeve në total të përfunduara nga gjyqtarja. Sa më sipër vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është në shkallën 0-10% dhe pikëzohet me 15 pikë.*

#### **2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, 01.01.2020-31.12.2022, gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 731 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat në total 258 jashtë këtij afati. Rrjedhimisht, gjyqtarja subjekt vlerësimi rezulton të ketë gjykuar 35% të çështjeve jashtë afatit standard minimal kohor në fuqi. Sipas kategorive ajo ka gjykuar 51 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtarë*”, 246 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë*”, 71 çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtarë*”, 10 çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtarë*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtarë*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtarë*”, 14 çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, 106 çështje të kategorisë “*krime*”, 69 çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, 2 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, 121 çështje të kategorisë “*seancë paraprake*”, si dhe 41 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”. Për kategoritë e mësipërme vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtarë;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit dhe të pasqyruara në raportin analitik, ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat lidhen me rrethanat objektive në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Gjyqtarja në mënyrë të detajuar se: “*Volumi i punës dhe kompleksiteti i çështjeve janë faktorë që ndikojnë në respektimin e afateve orientuese. Mendoj që i kam parashtruar më lart çështjet që duhen marrë parasysh në lidhje me këtë kriter. Duke përjashtuar faktorët që janë të pavarur nga vullneti i gjyqtarës mund të them se nga ana ime janë bërë të gjitha përpjekjet për të respektuar standardet minimale kohore.*”

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 258 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja muaj gusht i vitit 2020, ka ndikuar gjithashtu edhe periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr. 128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020.

Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit do të përfshiheshin periudhat e sipërcituara pushimet vjetore dhe ditët e pezullimi i veprimtarisë gjyqësore, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor.

Konkretisht:

Për vitin 2020, sipas raportit analitik gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 357 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 169 çështje jashtë këtij afati. Por ndërkohë disa prej çështjeve (*duke marrë parasysh sa me lart*) do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor, nëse ne zbresim pikërisht çështjet e mëposhtme :

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 7, 9, 11, 12,16, 18, 27, 32, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 251 ditë, 276 ditë, 252 ditë, 188 ditë,189 ditë, 207 ditë, 350 ditë, 210 ditë, 225 ditë, dhe 222 ditë, nga zbritja e ditëve të sipërcituara rezulton se janë gjykuar përkatësisht në afatin 175 ditë, 176 ditë, 147 ditë,148 ditë, 161 ditë, 169 ditë, 184 ditë (*tejkalim i papërfillshëm 4 ditë*), 173 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj/180 ditë.
- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 11,12, 50, 51, 52, 53, 54,55, 56, 57,58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 68,69,70,71,72, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 64 ditë, 64 ditë, 71 ditë, 71 ditë, 71 ditë, 71 ditë, 70 ditë, 81 ditë, 81 ditë, 81 ditë, 91 ditë, 91 ditë, 91 ditë, 91 ditë, 91 ditë, 101 ditë, 101 ditë, 101 ditë, 101 ditë, 105 ditë, 105 ditë, 105 ditë, 105 ditë, 105 ditë, por nga përlllogaritja duke bere zbritjen e ditëve të lejes vjetore dhe te periudhës së pezullimit te pandemisë rezulton se janë gjykuar përkatësisht në afatet 64 ditë, 64 ditë (*tejkalim i papërfillshëm prej 4 ditëve*), 30 ditë, 30 ditë, 30 ditë, 30 ditë, 29 ditë, 40 ditë, 40 ditë, 40 ditë, 50 ditë, 50 ditë, 50 ditë, 50 ditë, 50 ditë, 60 ditë, 60 ditë, 60 ditë, 64 ditë, 64 ditë,64 ditë, 64 ditë, 64 ditë (*tejkalim i papërfillshëm prej 4 ditëve*). Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj/60 ditë.
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 9, 17, 25, dhe 40, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 124 ditë, 143 ditë, 160 ditë, 126 ditë, por nga përlllogaritja duke bere zbritjen e ditëve te lejes vjetor dhe të periudhës së pezullimit te pandemisë rezulton se janë gjykuar përkatësisht në afatet 89, 122 (*tejkalim dy*

*dite i papërfillshëm*), 119 ditë, 120 ditë Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj/120 ditë.

- Në tabelën nr. 4, çështjet me nr. rendor 1 është gjykuar në afatin 63 ditë, por nga përlllogaritja duke bere zbritjen e ditëve e lejes vjetore rezulton se çështja e mësipërme është gjykuar ne afatin 28 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj/60 ditë.
- Në tabelën nr. 7, çështjet me nr. rendor 3, 4, 5, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 207 ditë, 193 ditë, 201 ditë, por nga përlllogaritja duke bërë zbritjen e ditëve te lejes vjetore rezulton se çështjet janë gjykuar përkatësisht në afatin 172 ditë, 158 ditë, 166 ditë. Ndërkohë, pika 5/e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj/180 ditë.
- Në tabelën nr. 8, çështjet me nr. rendor 36 çështje me objekt vepra penale që dënohen deri në 10 vjet burgim dhe është gjykuar në afatin 294 ditë, por nga përlllogaritja duke bere zbritjen e ditëve të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të situatës së COVID 19, rezulton se është gjykuar ne afatin 253 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 9 muaj/ 270 ditë.
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 18, 28, 40, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 158 ditë, 133 ditë, 158 ditë, por nga përlllogaritja duke bere zbritjen e ditëve te pushimit vjetor rezultojnë se janë gjykuar në afatet 123 ditë (*tejkalim i papërfillshëm prej 3 ditë*), 98 ditë dhe 117 ditë kësaj të fundit (*pasi i janë zbritur ditët e pezullimit te veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVOD 19*). Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj/120 ditë.
- Në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 132, 133, 137, cilat janë gjykuar në afatin 65 ditë, 65 ditë, 65 ditë, një tejkalim i papërfillshëm prej 5 ditëve çka mund të ketë ndikuar dhe periudha e mbartjes se dosjeve ne atë gjykatë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj /60 ditë.
- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 6, 7, 12, të cilat janë gjykuar në afatin 78 ditë, 78 ditë, 61 ditë por nga përlllogaritja duke bëre zbritjen e ditëve të lejes vjetore për gjyqësorin rezulton se janë gjykuar 43 ditë, 43 ditë dhe 61 ditë e cila është në tejkalim te papërfillshëm te afati prej 1ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj/60 ditë.

Për vitin 2021, gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 107 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 9 çështje jashtë këtij afati. Por ndërkohë disa prej çështjeve (duke marre parasysh sa me lart) do të kishin përfunduar brenda standardevë minimale kohor nëse ne zbresim pikërisht çështjet e mëposhtme :

- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 43, 44 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 63 ditë, 63 ditë nga te cilat duke zbritur periudhën e lejes vjetore, për këto dy çështje afati i gjykimit është përkatësisht 28 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e

aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj /60 ditë.

- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 3, 8 dhe 9, të cilat janë gjykuar në afatin 62 ditë (2 ditë tejkalim i papërfillshëm i afatit), 84 ditë dhe 84 ditë, nëse do zbritet periudha e lejes vjetore atëherë çështjet me nr. rendor 8 dhe 9, janë përfunduar në afatin 49 ditë secila. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj/60 ditë.

Për vitin 2022, gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 267 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 80 çështje jashtë këtij afati. Nga përlogaritjet e bëra ne raportin analitik, nëse ne do marrim në konsideratë që nga këto afate gjykimi do zbresim ditët e lejes vjetore atëherë nga numri total i çështjeve do zbriten çështjet si më poshtë vijon:

- Në tabelën nr. 2, çështjet me nr. rendor 32, 33, 34, 35, 36, 37 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 62 ditë, 62 ditë, 62 ditë, 62 ditë, 62 ditë, 62 ditë, nëse ne do zbresim ditët e lejes vjetore atëherë çështjet e mësipërme llogariten të jenë shqyrtuar në afatin përkatës secila prej 27 ditësh. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 9, 16, të cilat janë gjykuar në afatin 151, 143 ditë, nga të cilat duke zbritur periudhën e lejes vjetore, për këto dy çështje afati i gjykimit është përkatësisht 116 dhe 108 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj.
- Në tabelën nr. 4, çështjet me nr. rendor 4, e gjykuar në afatin 81 ditë nga të cilat duke zbritur periudhën e lejes vjetore, për këtë çështje afati i gjykimit është 46 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.
- Në tabelën nr. 8, çështja me nr. rendor 5, e cila përfshin çështje me objekt vepra penale që dënohen deri në 10 vjet burgim dhe është gjykuar në afatin 306 ditë, nga të cilat duke zbritur periudhën e lejes vjetore, për këto dy çështje afati i gjykimit është përkatësisht 28 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 9 muaj (270 ditë).
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 32, e gjykuar në afatin 137 ditë nga të cilat duke zbritur periudhën e lejes vjetore, për këto dy çështje afati i gjykimit është përkatësisht 122 ditë (2 ditë një tejkalim i papërfillshëm i afatit). Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj (120 ditë).
- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 5, 11, 21, të cilat janë gjykuar në afatin 75 ditë nga të cilat duke zbritur periudhën e lejes vjetore për këtë çështje afati i gjykimit është 40 ditë, ndërsa për dy të tjerat kemi një tejkalim të papërfillshëm prej 3 ditësh, 63 ditë, 63 ditë. Ndërkohë, pika

5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.

Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin çështjet e analizuara më sipër, atëherë do të rezultonte se nga 731 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 190 prej tyre ose 25.9% janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe analizës matematikore e logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të analizuara më sipër si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës siç kane qene shkaqet shëndetësorë apo periudha e pandemisë periudhe ne të cilën veprimtaria gjyqësore ka qene e pezulluar , vlerësoj se për këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përkon përqindjes së sipërcituar.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në raport me numrin total të çështjeve të gjykuara, tejkalimit të standardit minimal kohor në disa prej çështjeve të analizuara (*tejkalime nga 1, 3 ditë deri në 4 ditë*) sipas të dhënave statistikore, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja vlerësohet një shkallë më lart se 3 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues vlerësohet në nivelin “Mbi 10-20%”, duke e pikëzuar me 4 pikë.*

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

Në analizë tërësore të të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total: 731 çështje, duke përjashtuar çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi. Nga 731 çështje 51 çështje janë të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtarë*”, 246 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë*”, 71 çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtarë*”, 10 çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtarë*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtarë*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtarë*”, 14 çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, 106 çështje të kategorisë “*krime*”, 69 çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, 2 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, 121 çështje të kategorisë “*seancë paraprake*”, si dhe 41 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridikionale me jashtë*”.

1. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtarë*”, koha mesatare rezulton të jetë 185 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muajsh.
2. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë*”, koha mesatare rezulton të jetë 59,8 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal

- kohor i miratuar prej 2 muajsh.
3. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “familjare me palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 140 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muajsh.
  4. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “familjare pa palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 56 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muajsh.
  5. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “marrëdhënie pune”, koha mesatare rezulton të jetë 216 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muajsh.
  6. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “krime”, koha mesatare rezulton të jetë 88 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 9 dhe 12 muajsh.
  7. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “kundravajtje”, koha mesatare rezulton të jetë 85 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muajsh.
  8. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, koha mesatare rezulton të jetë 12 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muajsh.
  9. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “seancë paraprake”, koha mesatare rezulton të jetë 55 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muajsh.
  10. -Në lidhje me çështjet e kategorisë “kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”, koha mesatare rezulton të jetë 62,5 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh, një tejkallim i papërfillshëm me 2.5 ditë, çfarë na bën ta konsiderojmë si më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muajsh.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Nga të dhënat statistikore vlerësimi rezulton në nivelin mbi mesataren, por mendoj se vlerësimi për këtë kriter duhet të jetë maksimal (shumë i lartë), për shkaket sa më poshtë: Vlerësoj se duhet marrë parasysh volumi dhe kompleksitetit i çështjeve. Për këtë arsye, pavarësisht se janë tejkalluar afatet minimale të vendosura si standard, tejkallimi i tyre nuk ka ardhur si pasojë e mosadministrimit të mirë të kohës nga gjyqtarja, por nga rrethana të tjera të pavarura. Lidhur me kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, konstatohet se, standardet minimale kohore të përcaktuara në vendimin përkatës të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, i referohen parashikimeve ligjore, para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile. Kështu me parashikimet e reja është shtuar detyrimi për t’i lënë 30 ditë kohë palës së paditur që të dorëzojë deklaratën e mbrojtjes, duke filluar afati nga njoftimi i të drejtave dhe akteve përkatëse. Pa u dorëzuar deklarata e mbrojtjes ose kur nuk dorëzohet, pa kaluar afati ligjor 30 ditë, nuk mund të kryhen veprimet e tjera procedurale. Në këto kushte, duke marrë parasysh kohën për kryerjen e njoftimeve, rezulton se praktikisht duhet mbi 1 muaj e gjysmë para se të vazhdohet me veprimet përgatitore ose gjyqësore. Veçanërisht kur personat janë të larguar, duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike. Kështu në këto raste duhet mesatarisht mbi 2 muaj, para se të vazhdohet me veprimet përgatitore ose gjyqësore. Kjo sjell tejkallimin e afatit 6 muajor të përcaktuar. Si veprimet paraprake ashtu edhe vendimet e ndërmjetme që zbardh gjykata janë veprimtari e gjyqtarit që nuk reflektohet, megjithëse merr kohë të konsiderueshme gjykimi. Lidhur me kategorinë “seanca paraprake penale”, tejkallimi i afateve vjen si pasojë e shtyrjes së seancave kryesisht për mos njoftimin e palëve, jo për



*fajin e gjykatës, ashtu sikurse është argumentuar edhe në rubrikat më lart. Mendoj se për këtë kriter duhet vlerësuar edhe ngarkesa e punës si “drejtuese e gjykatës”, pasi duke qenë zëvendëskryetare, në mungesë të kryetarit, gjatë vitit 2022, kam ushtruar këtë funksion. Në këtë cilësi kam shqyrtuar mbi 20 kërkesa të gjyqtarëve për heqjen dorë nga gjykimi, si dhe kam nxjerrë shumë akte administrative, urdhra për organizimin e brendshëm, shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe kthimin e përgjigjeve për institucionet, si dhe jam angazhuar edhe në cilësinë e anëtarit/kryesuesit të Këshillit të Gjykatës, duke hartuar shumë vendime edhe për Këshillin e Gjykatës, veprimtari të cilat i janë shtuar edhe ngarkesës së përditshme të punës si gjyqtare.*

*Mendoj që shpjegimet e dhëna, janë të mjaftueshëm dhe të qarta për të treguar përkushtimin tim maksimal ndaj punës në kudër të respektimit të afateve ligjore në gjykimin e çështjeve.”*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve.

Sa më sipër duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për këtë tregues e cila parashikon se: “... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal” Gjyqtarja {...} ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm çështjes që sipas të dhënave statistikore (1030) rezulton me i madh se numri i çështjeve të caktuara (975) me një rendiment prej 105.6%. Ky fakt do të thotë se rritja e papritur e volumit të çështjeve për shkaqe të përmendura dhe nga vetë gjyqtarja në formularin vetëvlerësimit si dhe detyrave të saj në rolin e zv/kryetares, ka ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve brenda standardit minimal kohor duke bërë që gjyqtarja për këtë tregues të vlerësohet në pikëzim maksimal.

## **KONKLuzioni**

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.<sup>48</sup> Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 10 (dhjetë) kategori çështjesh, vetëm për 3 (tre) prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtarja vlerësoj se duhet të pikëzohet me 5 pikë.

---

<sup>48</sup>Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : “... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose barabartë me standardin për të gjitha kategoritë të çështjeve, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

#### **2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1030 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (975 çështje), është 105%, përqindje kjo që përkon me pikëzimin maksimal sipas metodologjisë. Nga 1030 çështje në total, të përfunduara nga gjyqtarja, 600 ose 61.5 % e tyre kanë qenë çështje me palë kundërshtare për gjithë periudhën e vlerësimit.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke e argumentuar si vijon: “Duke marrë në konsideratë numrin e lartë të çështjeve, kompleksitetin e tyre (kërkesa civile, civile themeli, kërkesa penale, penale themeli) si dhe rrethana të tjera objektive (pandemia Covid-19, periudha e shtatëzarisë, pjesëmarrja e detyrueshme në trajnimet vazhduese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës), vlerësoj se nga ana ime si gjyqtare është bërë maksimumi duke përballuar një ngarkesë të konsiderueshme të një numri të lartë çështjesh gjyqësore.”

#### **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarës për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 105 %, për këtë arsye vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet 10 pikë (+99%).

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që përkon me rendimentin e llogaritur prej 105%, duke u pikëzuar me 10 pikë (+99%).*

#### **2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022 është si më poshtë vijon.

Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 137 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 107 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 73 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 64 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 143 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*krime*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 115 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 127 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi, 58 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 5,5 ditë, pra më e gjatë se afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsyetuar.
- Për kërkesa me objekt verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe shqyrtim informacioni, 59 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, 45 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, 124 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K. Penal.
- Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për

arsyetimin e vendimit<sup>49</sup>, 16 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 27 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K. Pr. Penale.
- Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, 87 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për kërkesa me objekt përjashtimin e gjyqtarit, koha mesatare e arsyetimit është 187 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 22 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 12,5 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 476 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit<sup>50</sup>, 155 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka vlerësuar këtë tregues në nivel *mbi mesataren*, duke argumentuar si vijon: “*Vlerësoj se ngarkesa e lartë në punë lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kohën e arsyetimit të vendimeve. Megjithatë duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat objektive të poshtëshënuara, mendoj se vlerësimi im për këtë pikë duhet të konsiderohet mbi mesataren. Theksoj se gjatë vitit 2020-2022, kam gjykuar të gjitha llojet e çështjeve. Disa raste kam qenë e gatshme për shqyrtimin e çështjeve urgjente 15 ditë në muaj, për shkak të organikës jo të plotë, ku kam shqyrtuar kërkesa penale urgjente si vleftësim arresti caktim mase sigurimi, kërkesa të tjera penale urgjente, kërkesëpaditë për lëshimet e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes, kërkesa që duhet të shqyrtohen sipas rastit brenda 24 ose 48 orëve. Po ashtu kam gjykuar çështje si gjyqtare e deleguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, Lezhë dhe Pukë. Kështu të paktën 2 herë në muaj kam lëvizur në këto gjykata, ngarkesë kjo që duhet vlerësuar në kohën efektive të punës sime si gjyqtare. Duke mbajtur parasysh edhe se për çështjet civile duhen kryer një sërë veprimesh paraprake/përgatitore, të dokumentuara në vendime dhe urdhra përkatëse, ngel kohë e pakët në dispozicion për arsyetimet e vendimeve. Po kështu dhe arsyetimi i vendimeve të ndërmjetme (mase sigurimi padie, pezullim veprimesh përmbartimore, moskompetenca, etj), zënë një kohë të konsiderueshme të gjyqtarit. Duke marrë në konsideratë edhe kohën e zhvillimit të seancave gjyqësore, koha që ngelet në dispozicion të gjyqtarit për arsyetimin e*

<sup>49</sup> Këtu janë përfshirë çështjet me objekt “*Deklarim ikje*” dhe “*Zgjatje e afatit të paraburgimit*”, të cilat janë pasqyruar gabimisht në tabelën nr. 12.

<sup>50</sup> Këtu janë përfshirë edhe çështjet me objekt “*Caktim mase mjekësore*”, të cilat janë pasqyruar gabimisht në tabelën nr. 10.

vendimeve është minimale. Nga ana tjetër, arsyetimi i vendimeve gjyqësore pasqyron veprimtarinë e gjyqtarit përgjatë gjithë procesit gjyqësor dhe është një akt i cili ngelet dhe kërkon vëmendje dhe kohë.

Megjithatë, theksoj se jam munduar që arsyetimi i vendimeve të kryhet në kohë, por një fakt që ka ndikuar në mënyrë thelbësore në vonesën e arsyetimit të vendimeve në periudhën 2020-2021, ka qenë edhe gjendja ime shëndetësore (periudha e shtatzënisë), gjatë të cilës kam pasur raporte shëndetësore të vazhdueshme<sup>51</sup>, dhe nuk kam qenë në kushte optimale për të arsyetuar, pasi kam pasur një shtatëzani shumë të vështirë, fakt që e vështirësonte edhe distanca Tiranë-Kukës, për të shkuar në punë dhe numri i lartë i seancave gjyqësore të planifikuara për shqyrtim mesatarisht mbi 15 seanca në ditë. Në këto kushte, përtej mundësive të mia fizike kam qenë e detyruar të arsyetoj me përparësi vendime të ankuara, kërkesat për dërgimin e çështjeve në gjykim (jo më vonë se 10 ditë); vlerësimet e arresteve në flagrancë apo ndalimeve (neni 258, 259 i Kodit të Procedurës Penale) dhe çështje të tjera urgjente të cilat janë arsyetuar pas orarit zyrtar të punës, në kohën që kam qenë me raport si dhe në ditët e pushimeve. Ngarkesës së mësipërme, i duhet shtuar edhe ajo e punës si “drejtuese e gjykatës”, siç është relatuar në rubrikat pararendëse. Sa më sipër kam argumentuar, duke i dhënë përparësi shqyrtimit të çështjeve urgjente dhe arsyetimit të vendimeve përkatëse, jam vënë në pamundësi për t’i arsyetuar në afat çështjet e tjera që paraqiten më pak urgjente, edhe për shkak të objektivit shëndetësor të sipërcituara. Të gjitha këto rrethana kanë ndikuar dhe mendoj se duhen mbajtur parasysht në lidhje me vlerësimin sa i takon shpejtësisë së arsyetimit të vendimeve. ”

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, afati procedural është tejkuluar tek të gjitha kategoritë e çështjeve me përjashtim të njëres kategori për kërkesat me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit siç janë “Deklarim i keq” dhe “Zgjatje e afatit të paraburgimit”, e cila rezulton 16 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale. Referuar metodologjisë treguesi mesatar i kohës se arsyetimit të vendimeve gjyqësore vlerësohet në rastin konkret më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve dhe pikëzohet me 6 pikë, duke qenë se kemi vetëm një kategori për të cilën koha mesatare e arsyetimit të vendimit është me e shkurtër gjithashtu edhe duke marrë parasysht të gjitha shkaqet parashtruara nga gjyqtarja subjekt vlerësimi në formularin e vetëvlerësimit.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar vlerësoj se duhet të klasifikohet si “Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve” çka bën që gjyqtarja të pikëzohet me 6 pikë.

---

<sup>51</sup> Raportet mjekësorë i përkasin pikërisht periudhës se vitit 2021 përkatësisht në këto data: 25-29.1.2021; 01.02.5.2.2021; leje paralindje 09.02-16.03-2021; 04.03-06.05.2021; leje paslindje 06.05-05.06-2021;05.06-05.07-2021; raporte mjekësorë 17.11-18.11.2021; 20.12.2021-22.12.2021 . Gjithsej në total 170 ditë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” të klasifikohet si “Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve” dhe gjyqtarja pikëzohet me 6 pikë.*

## **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton të jetë 2 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile/K.Pr.Penale si dhe duke përcaktuar provat që do të shqyrtohen në gjykim.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: në kushtet e pamundësisë për arsye shëndetësore të gjyqtarës; me qëllim përsëritjen e njoftimit për viktimën; në kushtet e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore për shkak të situatës së krijuar prej Covid-2019; me qëllim përsëritjen e njoftimit për viktimën në kushtet e moskthimit të fletëthirrjes përkatëse; me qëllim njoftimin e viktimës përmes policisë gjyqësore; për t'i dhënë kohë prokurorisë për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore; për t'i dhënë kohë prokurorisë për paraqitjen e provave; në kushtet e mosparaqitjes së prokurores për arsye të ligjshme, me qëllim paraqitjen e konkluzione përfundimtare me shkrim, shpalljen e vendimit të arsytuar) etj. Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, por shume të ralla dhe të pavarura nga veprimet e gjyqtarës së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim. Ajo çfarë vërehet 21 dosjet burim vlerësimi, 16 prej tyre, gjyqtarja {...} i ka përfunduar gjykimet brenda 1 ose maksimumi 2 seanca gjyqësore.

## KONKLUZIONI

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2 seanca dhe gjyqtarja në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave duke e pikëzuar kështu sipas Metodologjisë me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, gjyqtarja është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (*neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes*) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (*neni 158/ç i K.Pr.Civile*) gjyqtarja ka disponuar me vendim për përcaktimin e provave që do të administrohen në gjykim.

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të paditurve, apo deklarin e mungesës për të pandehurin shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa më pak se 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca të mëdha kohore maksimumi deri në 15 minuta me vonësë dhe kjo vonese gjithmonë e justifikuar. Në raste kur kjo vonësë ka qenë më shumë se 15 minuta, kjo ka ndodhur për shkaqe të ndryshme dhe nuk rezulton që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relativitetit të gjyqtares lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar ose vonesës së prokurorit në gjykime të tjera.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

### **2.C Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore.**

#### **2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryerja nga gjyqtarja gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, rezulton se renditja akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore



lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.*

### **2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjyqimit. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (kërkesëpadia, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim), aktet e hartuara nga gjykata (aktet e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë përgatitore, komunikimet shkresore me të tretët, urdhri/vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, njoftimet për çdo veprim apo seancë, letra e të drejtave, procesverbalet e seancave përgatitore dhe seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore përfundimtare).

### **KONKLuzioni**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues. Në dosjet e vëzhguara nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “Shumë e lartë”, dhe duhet pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
90	Shkëlqyeshëm

### **3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE**

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij*

*kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

### **3.A Etika në punë**

#### **3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.**

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 1393/5 prot., datë 11.05.2023 rezulton se për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, për gjyqtaren {...} nuk është paraqitur asnjë ankesë,

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtares në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion duke shpjeguar se: *“Vlerësoj se gjatë ushtrimit të detyrës kam manifestuar sjellje shumë të mirë etike dhe profesionale. Një sjellje të tillë e kam manifestuar në raport me kolegët, stafin administrativ, palët në proces dhe përfaqësuesit e palëve duke u përpjekur në vazhdimësi për të dhënë maksimumin tim për të rritur besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Duke qenë se e konsideroj të rëndësishme paraqitjen dhe qëndrimin e gjyqtarit në raport me palët, jam treguar e kujdesshme, me qëllim shmangien e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti ndaj palëve dhe profesionit. Gjatë kohës që kam ushtruar funksionin e zëvendëskryetares, kam treguar angazhim maksimal në drejtimin e gjykatës, veprimtarisë së saj, mbledhjeve të Këshillit të Gjykatës dhe Mbledhjeve të Gjyqtarëve, duke i dhënë zgjidhje problematikave të ndryshme që dalin gjatë veprimtarisë në punë, duke treguar një sjellje etike dhe korrekte me stafin dhe kolegët.”.*

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” pikëzohet me 35 pikë.*

### **3.B Integriteti i gjyqtares**

#### **3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, nuk rezulton të jetë regjistruar pranë ILD ankesë kundrejt gjyqtares {...} për periudhën e vlerësimit 2020-2022.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, për gjyqtaren {...} nuk është depozituar asnjë ankesë. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

Referuar raportit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për gjyqtaren {...}, përcjellë pranë KLGJ-së me shkresën nr. 1948/3 prot. datë 14.07.2023 rezulton se:- *Deklaratat e interesave private “Para Fillimit të Detyrës 2019-Periodike Vjetore 2022” janë dorëzuar brenda afateve ligjore.- Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit;-Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.*

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin e integritetit në shkallë shumë të lartë duke shpjeguar se: *“Duke vlerësuar rëndësinë e sjelljes dhe figurës së gjyqtarit kam respektuar standardet e sjelljes profesionale jo vetëm gjatë punës por edhe jashtë saj duke u sjellë me seriozitet, dinjitet dhe integritet.*

## **KONKLUZIONI**

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

### **3.C Paanësia e gjyqtares**

### ***3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarës.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### ***3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2020–31.12.2022, janë paraqitur 3 (tre) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës, nga të cilat 2 (dy) kërkesa janë pranuar për përjashtimin e saj nga gjykimi. Po kështu, rezulton se edhe vetë gjyqtarja ka paraqitur 23 (njëzet e tre) kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

#### **KONKLuzioni**

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se në gjithë periudhën 3/vjeçare, ka vetëm dy kërkesa të pranuar për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimi.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### 4.A Aftësia e komunikimit.

##### 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarës për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. I njëjti konstatim rezultojnë edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

#### KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezultojnë se gjyqtarja në çdo rast komunikojnë në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### ***4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtarja vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicje për cenim të konfidencialitetit apo të dhënat personale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

#### **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar.**

***4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtarja ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

### **KONKLuzioni**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtares për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### **4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtares në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...} gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 12 aktivitete trajnuese të cilat kanë zgjatur për 17 ditë kalendarike.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtarja në formularin e vetëvlerësimit ka deklaruar se “Gjatë periudhës së vlerësimit kam marrë pjesë rregullisht në trajnimet vazhduese të kryera nga Shkolla e Magjistraturës, ashtu si edhe në çdo trajnim/takim që ka pasur në fokus punën e Këshillit të Gjykatës dhe administrimit gjyqësor, të organizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, duke përmblusur detyrimet e mia për pjesëmarrje në programet e trajnimit vazhdues.”.

## KONKLZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 12 aktivitete të zhvilluara për 17 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

***Pjesëmarrja e gjyqtares në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtares në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

### **4.C.b Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.**

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, ne baze te informacioni të përcjelle nga Shkolla e Magjistraturës me shkresën me nr.301/8 Port datë 02.05.2023 nuk rezulton qe gjyqtarja {...} të jetë angazhuar në cilësinë e lehtësueses apo trajnueses. Po ashtu nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në udhëheqjen e kandidatëve për magjistratë gjatë periudhës së stazhit profesional, por gjithashtu nuk rezultojnë të dhëna për zhvillimin e këtij aktiviteti pranë gjykatës ku ajo ka ushtruar funksionin.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

## KONKLZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues pranë Shkollës së Magjistraturës apo të ketë pasur mundësi të udhëheqë kandidatët për magjistratë gjatë stazhit profesional.

***Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares dhe për pasojë, pikëzohet me 3 pikë.*



#### ***4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, si dhe formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtares, si dhe akteve të paraqitura nga gjyqtarja lidhur me këtë tregues, rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit nuk është angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo siç është mësimdhënia.

Nga burimet e vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrje të gjyqtares në aktivitete të tjera ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të mos të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale dhe konkretisht në veprimtarinë e mësimdhënies, gjatë periudhës së vlerësimit.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari*

*për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja pikëzohet me 3 pikë.*

#### ***4.C.ç Publikimet ligjore akademike.***

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezultojnë të dhëna.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

*Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtares, duke e pikëzuar me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

## F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	90	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	381	Shkëlqyeshëm

## PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR